



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0658

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Via Egnatia Sh.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë të Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit 133 Pikat ushqyese për qentë endacak (furnizimi dhe shpërndarja e ushqimit) dhe QTE me numër të prokurimit: 616-24-1368-1-1-1, me 10/09/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE Via Egnatia Sh.P.K. me nr. 2024/0658 , e datës 22/07/2024, kurse vendimi i AK Komuna e Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit 133 Pikat ushqyese për qentë endacak (furnizimi dhe shpërndarja e ushqimit) dhe QTE me numër të prokurimit: 616-24-1368-1-1-1, mbetet në fuqi.
2. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik Via Egnatia Sh.P.K

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 19.03.2024, Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit.

Ndërsa me datën 04.07.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontrate “Al Tech Sh.P.K.”

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim me vlerë të parashikuar të kontratës : 150.000.00 €.

Me 09.07.2024, OE Via Egnatia Sh.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 09.07.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 22.07.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Via Egnatia Sh.P.K me numër protokolli 2024/0658 lidhur me aktivitetin e prokurimit 133 Pikat ushqyese për qentë endacak (furnizimi dhe shpërndarja e ushqimit) dhe QTE me numër të prokurimit: 616-24-1368-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Via Egnatia Sh.P.K janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i pare (I): “ 1. AK ka shkelur nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së pasi që gjatë procesit të ri-vlerësimit të ofertave dhe administrimit me procedurën e prokurimit, nuk ka luajtur aspak rol aktiv për tu siguruar që fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë efikase dhe ekonomike. Kjo ka ardhur si pasojë e mos respektimit në mënyrë të drejtë dhe objektive të kërkesave dhe kritereve të parapara në Njoftimin për Kontratë si dhe në Dosjen e Tenderit. Më saktësisht AK pa të drejt ka shpërblyer me kontratë OE “AL-TEC” SH.P.K. të cilët e posedojnë çmimin më të lartë se tenderi jonë për 31,010.00€ përkatësisht për 32.7% ndërsa në të njëjtën kohë na ka eliminuar neve për një mangësi që nuk e ka pasur fare si kërkesë të dosjes së tenderit. Bazuar në nenet e cekura më lartë si dhe bazuar në nenin 4.1.c të RRPP-001/2022, AK është e obliguar të luaj rol aktiv në shpenzimin e parasë publike në mënyrën më ekonomike të mundshme. Përpos kësaj AK ka bërë edhe një gabim shumë jo profesional duke na eliminuar nga konkurrenca për një kërkesë që nuk e ka pasur fare tek kërkesat e dosjes së tenderit (Fleta e të dhënave të tenderit), veprim i cili bie plotësisht ndesh me nenin 56.3 të LPP-së. Bazuar në këtë që e thamë më lartë dhe marrë për bazë kërkesat e dosjes së tenderit, konstatohet se AK ka shkelur plotësisht nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së si dhe nenin 4 të RRPP-001/2022 duke mos vlerësuar tenderët në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit si dhe duke mos administruar procedurën sipas neneve të cekura më lartë.”

Pretendimi i dyte (II): “2. AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së me rastin e ri-vlerësimit pasi që nuk i ka trajtuar aspak si të barabartë tenderuesit pjesëmarrës. Neve na ka eliminuar me arsyetimin se gjoja nuk kemi ofruar katalogje apo specifika teknike edhe pse në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë nuk është kërkuar askund diçka e tillë ndërsa e ka shpallur fitues një OE që nuk i ka plotësuar kërkesa e specifikimeve teknike që ishin të vendosura tek Aneksi 1. Ky është aplikim selektiv i një kriteri që ligjërisht është papranueshëm. Mos dhënia e mundësisë për plotësim të tenderit tonë me katalogje apo dëshmi nga prodhuesi gjë të cilën e parasheh shumë qartë nenin 72 i LPP-së, dhe shpërblimi i një OE me specifikime teknike të mangëta dhe të ndryshme nga ato që ishin kërkuar në Aneks 1, është dëshmi dhe argument i mjaftueshëm që tregon se AK ka shkelur plotësisht nenin 7 të LPP-së. Shkeljet e cekura do të i elaborojmë dhe argumentojmë me fakte tek pretendimi për shkeljen e nenit 56, 59 dhe 60 të LPP-së.”

Pretendimi i trete (III): “3. AK ka shkelur nenin 56 të LPP-së pasi që gjatë ri-vlerësimit të tenderit tonë na ka eliminuar për një kërkesë që nuk e kishte fare tek dosje e tenderit e as tek Njoftimi për Kontratë. Arsyetimi për anulim është që gjoja ne nuk kemi dorëzuar katalogje apo të dhëna teknike rreth artikujve edhe pse asnjëra nga këto nuk ishte kërkuar tek dosja e tenderit. Paragrafi 3 i nenit 56 të LPP-së e thotë qartë. Pra me që kërkesa e tillë nuk ka qenë kërkesë mandatore e vendosur tek FDT e dosjes së tenderit, AK nuk ka pasur të drejtë të na eliminoj nga konkurrenca pa na kërkuar sqarime shtesë sidomos kur me një veprim të tillë e kishte kursyer buxhetin për 30% në krahasim me kontratën që synon ta nënshkruaj. Kërkesat e aneksit 1 janë të dhëna që përdoren gjatë implementimit të kontratës, dhe me që tek FDT nuk është kërkuar ndonjë dëshmi rreth tyre, AK nuk ka të drejtë ta eliminoj ndonjë OE që nuk ka dorëzuar katalogje. Mos dorëzimi i katalogut që edhe ashtu nuk ishte kriter/kërkesë e FDT-së, nuk nënkupton automatikisht që ne nuk i plotësojmë specifikimet teknike sepse ne jemi deklaruar që i plotësojmë pa kufizim të gjitha dispozitat e sajë. Është e çuditshme se si AK ndaj neve aplikon kërkesa që nuk ishin fare tek FDT ndërsa ndaj OE që e ka shpallur fitues nuk e respekton specifikimin teknik ku shihet se ky nuk e ka plotësuar. Krejt kjo tregon se AK gjatë ri-vlerësimit të tenderëve ka shkelur plotësisht nenin 56.3 të LPP-së.”

Pretendimi i katërt (IV) : “4.AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk i ka respektuar kërkesat e veta nga dosja e tenderit dhe nuk i ka aplikuar drejtë dispozitat e LPP-së. Arsyetimi i AK-së për cilësim të tenderit tonë si të papërgjegjshëm duke mos vlerësuar sipas dispozitave dhe rregullave të LPP-së. Pretendimi jonë ndaj arsyes për eliminim është se AK nuk ka pasur të drejtë të na eliminoj nga konkurrenca në asnjë rrethanë pa kërkuar sqarime rreth asaj që thekson në arsyetim e sidomos kur shihet se kërkesa për dëshmi të tilla nuk ka qenë askund në dosjen e tenderit. Aneksi 1 është dokument mandator i respektimit gjatë implementimit të kontratës nga kushdo që shpallet fitues ndërsa nëse AK nuk ka vendosur ndonjë kërkesë tek FDT që të ofrohet ndonjë katalog apo specifikim teknik detal nga prodhuesi, nuk ka asnjë të drejtë ta eliminoj ndonjë tenderues me arsyetimin e tillë. Ja si duket FDT tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ku do duhej të ishte kërkesa për dorëzim të katalogut apo të dhënave teknike. Pra po shihet se askund nuk kishte ndonjë kërkesë për të ofruar

të dhëna të tilla. Përpos kësaj, AK tek Aneksi 1 ka vendosur vetëm kërkesa që duhet respektuar me rastin e shpërndarjes së ushqimit dhe askund nuk e ka cek se ato duhet dëshmuar gjatë tenderimit. Kërkesat që duhet dëshmuar gjatë tenderimit ligjërisht vendosen tek FDT e dosjes së tenderit ndërsa ato tek Aneksi 1 janë për implementim të kontratës. Me që Aneksi 1 nuk posedon fare tabelën ku duhet plotësohet dhe nënshkruhet nga OE, tregon se jo detyrimisht duhet dorëzuar si dokument. Ngjashëm sikur se anekset tjera që ndodhen në dosje e që janë të aplikueshme vetëm nëse tek FDT ekziston kërkesa për diçka të tillë, ashtu vlen edhe për aneksin 1. Me që ne tek formulari i tenderit ne jemi deklaruar se i pranojmë dispozitat e dosjes së tenderit në tërësi pa asnjë kufizim, tregon mjaftueshëm se ne jemi pajtuar me specifikimet e tilla teknike dhe tenderi jonë është dashur të pranohet si i rregullt. Ja si duket deklarimi i tillë tek formulari i tenderit. Pra me që nuk ka pasur kërkesë tek FDT që të dorëzohet ndonjë specifikim teknik apo katalog i prodhuesit, AK është dashur ta pranoj tenderin por që gjatë pranimi të mallrave të sigurohet se ato përmbushin kërkesat nga të dhënat tek Aneksi 1, apo edhe të kërkoj sqarim ashtu siç e parasheh neni 72 i LPP-së. Paragrafi 3 i nenit 72 të LPP-së. Pavarësisht asaj që në FDT të Dosjes së Tenderit nuk kishte kërkesë për katalogje apo të dhëna teknike, nëse AK ka pretenduar se neve na mungojnë dëshmitë e tilla, ka mundur të na sqaroj sipas asaj që e thotë neni 72 i LPP-së. Shumë qartë po shihet tek kjo dispozitë ku ceket se kur një dokument ti tillë mungon, AK duhet lejuar plotësimin e tenderit, sidomos kur me këtë veprim kursen 30% të buxhetit të AK-së për këtë tender. Edhe neni 38 i RRPP-001/2022 e tregon se si duhet vepruar AK në rastet e tilla. Me që katalogjet dhe të dhënat teknike janë pjesë e nenit 69 të LPP-së që përshkruhen tek paragrafi 2.4 i këtij neni, atëherë sipas dispozitave të nenit 38 të LPP-së, AK është dashur të i kërkoj si sqarime shtesë. Ja si e përshkruan detyrimin e AK-së neni 38 i RRPP-001/2022. Është paradoksale që një OE me çmim 30% më të ulët të eliminohet pse mungon katalogu ndërsa të shpërblehet një OE që nuk e plotëson specifikimin teknik sipas kërkesave që ishin të përcaktuara nga AK. A nuk është standard i dyfishtë i aplikimit të ligjit kjo? Pas gjithë këtyre sqarime dhe argumentimeve të ofruara, shihet qartë se AK nuk ka vlerësuar drejt tenderin tonë dhe për pasojë ka shkelur plotësisht edhe neni 59 të LPP-së. Këtu vlen të theksohet edhe që AK nuk e ka vlerësuar si duhet as tenderin OE “AL-TEC” SHPK të cilin edhe e ka shpallur fitues. Këtë e themi për faktin që i njëjti ka mangësi në tenderin e tijë pasi që specifikimet teknike nuk përputhen me ato që AK kishte kërkuar. Këtë e themi pasi që në ushqimin e ofertuar gjendet lëndë Omega 9 e cila nuk ishte tek kërkesat e AK-së. Përpos kësaj shihet se edhe yndyrat nuk janë në lartësinë e kërkuar nga AK, ushqimi posedon elemente që AK nuk i ka paraparë tek Aneksi 1 siç është mishi i deles dhe i dërrit, andaj ushqimi i ofertuar nga ky OE nuk i plotëson kërkesat e AK-së. Edhe më të rëndë e bënë mangësinë në specifikime teknik fakti që tek ushqimi i ofertuar nga ky OE gjenden elemente shtesë që AK nuk i ka paraparë tek specifikimi teknik. Disa nga këto elemente janë p.sh.: fibra e papërpunuar me 2.2%; lëndë inorganike me 5.1%, etj. Mjafton të shikohet specifikimi teknik dhe të krahasohet me atë çka ka ofruar ky OE dhe do shihet qartë që ushqimi ka ndryshime të theksuara e që sipas ligjit nuk duhet pranuar. Pra me që elementet e tilla nuk janë paraparë që të ndodhen tek ushqimi i specifikuar, atëherë ligjërisht nuk lejohet edhe të ofrohen, çka e bënë specifikimin e tillë të papërshtatshëm/pakompletuar ndërsa OE kjo e bënë të papërgjegjshëm. Ja si duket specifikimi i ofruar nga ky OE. Me që sipas kërkesave të AK-së ne jemi tenderues i përgjegjshëm dhe kemi çmimin më të ulët në krahasim

me të gjithë tenderuesit tjerë, atëherë nuk po lëshohemi në përshkrimin detal të mangësive në tenderët tjerë sepse po e konsiderojmë si irelevante për faktin që pas sqarimit të tenderit tonë sipas nenit 72 të LPP-së ligjërisht ne do të shpallemi prap si fitues. Se AK po e përkrahë hapur dhe me çdo kusht OE që e ka shpallur fitues edhe përkundër faktit që nuk është i përgjegjshëm, e tregon qartë fakti që AK nuk ka kthyer fare përgjigje në pretendimin tonë lidhur me mosplotësimin e specifikimit teknik nga ana e OE të shpallur fitues. Edhe kjo shkelje i shtohet dhe e bënë edhe më të rënd shkeljen e nenit 7 të LPP-së mbi trajtimin e pa barabartë që po bën AK, duke e favorizuar OE AI-Tec SHPK dhe duke na diskriminuar neve. Edhe arsyetimi i refuzimit të pretendimit tonë për mos kërkim të sqarimeve shtesë konsiderohet si tentim për mashtrim të opinionit sidomos kur thekson se nuk sqarohet një dokument nëse OE nuk e ka dorëzuar fare. Ja si e përshkruan neni 72 i LPP-së këtë. Me që po shihet se AK nuk është përgjigjur si duhet në pretendimin për përgjegjshmërinë tonë dhe nuk është përgjigjur fare as për pretendimin lidhur me mangësitë e OE të shpallur fitues, tregon qarë se përpos neneve tjera ka shkelur edhe nenin 108?A të LPP-së. Nisur nga krejt kjo që e thamë më lartë, shihet se me rastin e ri-vlerësimit, sqarimit/mos sqarimit dhe krahasimit të tenderëve, AK kanë shkelur plotësisht nenin 59 të LPP-së.

Pretendimi i peste (V): “5. AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së pasi që nuk i ka respektuar kërkesat e dosjes së tenderit të vendosura në përputhje me LPP-në dhe si pasojë e kësaj ka shpërblyer me kontratë një OE që posedon çmimin më të lartë se ne për 32.7% përkatësisht për 31,010.00€. Kjo konsiderohet shkelje e plotë e të gjitha dispozitave që flasin për administrimin e drejtë të parasë publike si dhe konsiderohet shkelje e plotë edhe e kriterit të vlerësimit të vendosur në përputhje me nenin 60 të LPP-së që ishte - Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët.”

Pretendimi i gjashtë (VI): “6. AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së gjatë procesit vlerësimit sepse nuk ka kërkuar fare sqarime për disa paqartësi që shihet se i ka pasur tek tenderi jonë dhe pavarësisht kësaj, AK ka vepruar në mënyrë arbitrare duke na eliminuar për mangësi që do duhej sqaruar detyrimisht. Detyrimi i AK-së tregohet shumë qartë tek neni 72 i LPP-së si dhe tek neni 38 të RRPP-001/2022 ku përshkruhet detalisht se si duhet vepruar për të sqaruar mangësitë dhe paqartësitë në tenderët konkurrues. Në vazhdim po paraqesim vetëm atë që e kërkon neni 72 i LPP për sqarim të tenderëve. Pra bazuar në këtë që e thotë ky nen, shihet hapur se AK është dashur të kërkoj sqarime për të gjitha paqartësitë që i ka pasur rreth dëshmimeve tona e veçanërisht për dëshminë specifikimit teknik. Anulimi i tenderit tonë për arsyet e eliminimit të cekur tek dhe anulimi i tenderit tonë duke i thirrur kinse në një të drejtë ligjore, në fakt përbën ë shkelje të plotë të nenit mbi vlerësimit e tenderëve dhe njëkohësisht përbën shkelje edhe të nenit 72 të LPP-së.”

Duke u referuar kërkesave si më sipër OE Via Egnatia Sh.P.K. konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Neni 1, 6, 7, 56, 59, 60, 72 të LPP-së. Bazuar në krejt këtë që theksuam më lart kërkojmë nga OSHP që të merr: Vendim të Aprovohet si e bazuar ankesa e OE “Via Egnatia Sh.P.K” lidhur me tenderin “133 Pikat ushqyese për qentë endacak (furnizimi dhe shpërndarja e ushqimit) dhe Te”. Anulohet Njoftimi mbi Vendimin e AK

–Komuna e Prishtinës dhe lënda të kthehet në Ri-Vlerësim. Ri-vlerësimi të bëhet bazuar plotësisht në kërkesat e dosjes së tenderit dhe të LPP-së ku më pas do duhej që Fitues të shpallej OE “Via Egnatia Sh.P.K.”.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar lidhur me rekomandimin e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar me rekomandimin e eksperti shqyrtues.

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim: “Sipas Vendimit të ZPP-së të datës 21.06.2024. ndaj kërkesës për Rishqyrtim . OE " Via Egnatia Sh.P.K. nuk keni ofruar asnjë dëshmi në ofertën e juaj. lidhur me Aneksin I – Specifikimet teknike të Detyrueshme. për specifikat e ushqimit. vlerat ushqyese, të dhënë ne dosjen e tenderit. Andaj edhe eliminoheni. Në aneksin 1 të dosjes së tenderit janë përcaktuar kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me specifikat teknike të detyrueshme. Nuk është aspak kontestues fakti që parashtruesi nuk ka dorëzuar dëshmitë e kërkuara lidhur me specifikat teknike të detyrueshme ku ndër të tjera është kërkuar që përmbajtja e ushqimit të prezantohet me katalog nga prodhuesi me përshkrim të specifikuar. Pas vlerësimit me kujdes të kërkesës për rishqyrtim është gjetur se parashtruesi e pranon faktin që nuk ka dorëzuar dëshmitë e nevojshme për specifikat teknike të detyrueshme. Pjesa e vetme që e konteston parashtruesi është se kërkesat për specifikat teknike të detyrueshme nuk kanë qenë pjesë e dosjes së tenderit. Ky pretendim si i tillë është në tërësi i pabazuar pasi që specifikat teknike të detyrueshme janë përcaktuarpërmes aneksit 1 të dosjes së tenderit. Pra të gjitha anekset e dosjes së tenderit janë pjesë integrale e dosjes së tenderit dhe ky fakt nuk është aspak kontestues pasi që parashtruesi ka plotësuar në mënyrë të rregullt anekset tjera si p.sh aneksin 2 - Deklaratën nën betim, etj. Pra konkretisht sa i përket pretendimit të parashtruesit se arsyeja për eliminimin e tij nuk është përcaktuar me dosjen e tenderit, ky pretendim nuk qëndron sepse arsyeja për eliminimin është përcaktuar përmes aneksit 1 të dosjes së tenderit (konkretisht faqja nr. 20 e dosjes së tenderit). Nëse parashtruesi ka pasur paqartësi lidhur me faktin se anekset e dosjes së tenderit a janë ose jo pjesë e dosjes së tenderit, atëherë parashtruesi ka pasur mundësi që të bëj pyetje sqaruese te autoriteti kontraktues para hapjes së ofertave. Sa i përket pjesës së pretendimit të parashtruesit se dosje e tenderit konsiderohet vetëm Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT) por jo edhe anekset e dosjes së tenderit, duhet cekur se edhe ky pretendim është i pabazuar në tërësi pasi që Dosja e Tenderit është dokumenti me emërtimin e njëjtë dhe pjesë përbërëse e tij janë të gjitha pjesët e bashkangjitura me të (FDT, Anekset, etj) sikurse është publikuar në platformën e prokurimi. Sa i përket pjesës së pretendimit të parashtruesit ku thuhet se AK është dashur të kërkoj sqarime shtesë lidhur me këtë kërkesë të dosjes së tenderit, duhet cekur se kjo pikë e pretendimit është mjaft kundërthënëse pasi që në një pjesë të kërkesës për rishqyrtim parashtruesi e konteston faktin se ekziston kërkesa e dosjes së tenderit dhe në pas thotë se kërkesa ekziston por është dashur të kërkohen sqarime. Lidhur me këtë pjesë duhet cekur se AK nuk ka pasur mundësi të kërkoj sqarime për një dokument që nuk e ka dorëzuar fare parashtruesi pasi që kjo do të përbënte ndryshim material thelbësor të ofertës. Pra në rast se parashtruesi do të kishte dorëzuar një pjesë të katalogut ose një dokument të ngjashëm me katalog, AK ka pasur të drejtë që të shqyrtoj mundësinë për të kërkuar sqarime shtesë ose jo. Por

edhe në këtë rast nuk do të ishte detyrim mandator i AK por vetëm diskrecion pasi që AK nuk merr përgjegjësi për gabimet që mund të bëj një OE me rastin e përgatitjes së ofertës. Kjo përcaktohet përmes nenit 32 par. 4 të RRPP ku thuhet se "Është përgjegjësi e ofertuesit të ngarkoj të gjitha dokumentet e kërkuara në sistemin e prokurimit elektronik para afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve". Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi. Sa i përket pretendimeve të tjera ankimore të drejtuara kundër tenderuesve të tjerë në këtë aktivitet të prokurimit, duhet sqaruar se parashtruesi përderisa vet ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të dëshmoj asnjë interes të vetëm material nga cilido rezultat i aktivitetit të prokurimit në raport me këto pretendime të tij ankimore të drejtuara kundër tenderuesve të tjerë. Përmes nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP përcaktohet se "Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar". Nga këndvështrimi i kësaj dispozite të LPP, përderisa parashtruesi për vete ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit, dhe nuk ka arritur që të dëshmoj të kundërtën as me këtë kërkesë për rishqyrtim, atëherë i njëjti nuk është palë e interesuar në raport me pretendimet e tij ankimore kundër tenderuesve të tjerë. Megjithatë duhet cekur se tenderuesi i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar ofertë tërësisht të përgjegjshme. Në fakt oferta e tenderuesit të rekomanduar është ofertë e përgjegjshme me çmimin më të lirë. Prandaj rekomandimi për dhënie të kontratës nga komisioni vlerësues është në përputhje të plotë me kriteret e dhënies së kontratës sipas dosjes së tenderit. Me fjalë të tjera, edhe po të ishte palë e interesuar parashtruesi në raport me këto pretendime, sërish pretendimet e tij janë në tërësi të pabazuara. Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001 / 2022 për Prokurimin Publik. Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi."

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 25/07/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0658/2024, ndërsa me datë 08/08/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0658 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr

parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Via Egnatia Sh.P.K . eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0658 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i pare (I) : “Operatori ekonomik ankues ne ankesën e vet ka theksuar shkelje ligjore te disa neneve qe janë shkelur nga AK-KK Prishtinë mirëpo ne fakt kemi te bëjmë vetëm me një pretendim ankimor mbi arsyen e eliminimit, te cilin e gjeni te bashkangjitur ne ekspertize. Eksperti shqyrtues ne lidhje me këtë pretendim ankimor sqaron se tek kriteret e përzgjedhjes saktësisht tek kapaciteti teknik dhe profesionale ne dosje te tenderit nuk ka ndonjë kërkesë specifike se cila duhet te jetë dëshmia e ofruar mbi plotësimin e specifikimeve teknike, kriteret e përzgjedhjes kanë qenë si ne vijim : Kapaciteti teknik dhe profesional: 1.Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmitë se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë), siç është specifikuar në njoftimin për kontratë. 2.Operatori Ekonomik duhet te posedoj Certifikatën ISO 22000 2018. 3.Operatori Ekonomik duhet të ketë dy (2) punëtor për shpërndarjen e ushqimit në pikat ushqyese. 4.Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit ; Aneksin 7 te DT. Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1.Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te furnizimeve. 2. Kopje e certifikatës ISO 22000 2018,me validitet 3. Kontratat e punës me punëdhënësin ose marrëveshje për angazhim ne këtë projekt. 4. OE duhet të plotësoj dhe dorëzoj listën e pajisjeve duke plotësuar Aneksin 7 duke i bashkangjitur librezat valide. Në rast të marrjes me qira duhet të dëshmohet me marrëveshje të noterizuar në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit. Sipas kërkesave te mësipërme nuk është e çartë se cila ka qenë dëshmia qe duhet ofruar operatoret ekonomik lidhur me plotësimin e specifikimeve teknike sipas aneksit 1 te dosjes se tenderit sepse një kërkesë e tillë nuk ka qenë e specifikuar ne dosje te tenderit apo ne njoftimin për kontratë, dhe ne këtë mënyrë gjatë përgatitjes se dosjes se tenderit AK-Komuna e Prishtinës nuk ka marrë për bazë nenet si në vijim: 17.12 Rregullores për Prokurim Publik , citat neni : Në dosjen e tenderit AK do të deklarohet të gjitha informatat relevante për kontratën në fjalë që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Informata të tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies

së kontratës. Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Sipas nenit 25.5 të Rregullores për Prokurim Publik, citat neni “ Kriteret e përzgjedhjes do të specifikohen qartë në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit, si dhe, çdo dokument apo informatë tjetër që OE i interesuar kërkohet të dorëzoj në mënyrë që të konsiderohet i kualifikuar”. Po ashtu neni 40.2 i po të njëjtës Rregullore përcakton se “Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do ti jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Nga kjo konstatojmë se vetëm kriteret e përcaktuara paraprakisht në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë duhet të merren parasysh gjatë procedurës së ekzaminimit dhe vlerësimit të tenderëve. Sqarojmë se vlerësimi i tenderëve duhet të bëhet në harmoni të plotë me nenin 56 pika 3 të LPP-se dhe nenin 59 të LPP-së. Bazuar në përshkrimin e mësipërm rekomandojmë AK-KK Prishtinë që gjatë procedurës së RI-Vlerësimit në këtë rast të veproj sipas nenit 72 të LPP-se dhe nenit 38 të Rregullores për Prokurim Publik 001/2022 dhe të kërkoj sqarimet e nevojshme tek OE ankues (njëherë ofertues me çmim me të ulët) në lidhje me specifikimet teknike të kërkuara sipas aneksit 1 të dosjes së tenderit. Nga përshkrimi i mësipërm, kërkesave të dosjes së tenderit , pretendimeve ankimore të përshkruara në ankesë, nenit 6 , 59 dhe 72 të LPP-se dhe nenit 38 të Rregullores për Prokurim Publik rekomandojmë panelin shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar dhe lënda të kthehet në RI-VLERËSIM, sipas arsyetimeve të lartcekura. Bazuar në përshkrimin e bërë me sipër sipas shkresave të lendes, raportit të rivlerësimit, dosjes së tenderit, pretendimeve ankimore të OE ankues, ekspertit shqyrtues rekomandon panelin shqyrtues që të anulohet : Vendimi i AK-së i datës 04.07.2024 mbi dhënien e kontratës. Ankesa e operatorit ekonomik ankues të merret si e bazuar. Lënda të kthehet në Rivlerësim, sipas arsyetimeve dhe përshkrimit të lartcekur.”

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, ka pasur nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ka qenë e nevojshme të dëgjohen edhe palët.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e OSHP lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh

natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit Paneli Shqyrtues ja fal besimin pjesërisht raportit të ekspertit shqyrtues, ngase duke u bazuar në gjendjen faktike dhe pretendimin e ankuesit se oferta e tyre është refuzuar nga AK me arsyetimin se nuk janë ofruar dëshmitë rreth specifikimeve teknike. Duke ju referuar Dosjes së Tenderit, AK ka vendosur specifikimet teknike tek Aneksi 1 i Dosjes së Tenderit ku secili OE kur Aktiviteti i Prokurimit ka të bëjë me furnizime, Specifikimet teknike formojnë bazën për vlerësimin e ofertave në mënyre të drejtë dhe OE pjesëmarrës në tender me rastin e ofertimit duhet ta dëshmoj se furnizimet që do ti bëjë do të jenë konform këtyre kërkesave të përcaktuara tek Aneksi 1 i Dosjes së Tenderit. Andaj, arsyeja se pse PSH nuk ja fal plotësisht besimin e ekspertit është se AK tek Aneksit 1 të DT, ka vendosur Specifikimet Teknike të Detyrueshme, për të cilat të gjithë OE pjesëmarrës kanë qenë dashtë ti plotësojnë dhe OE ankues në këtë rast nuk ka sjell as katalog as ndonjë dëshmi tjetër se ato furnizime do të jenë konform kërkesave të AK, në mënyrë që AK të sigurohet për furnizimet që do ti kontrakttoj. PSH konsideron se këtë OE ka qenë dashtë ta sqaroj me AK para ofertimit, sqarim të cilin ja lejojnë dispozitat ligjore konkretisht neni 53 i LPP, me çrast në fazën e para ofertimit çdo palë e interesuar nëse ka interes që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit dhe konsideron se kërkesat e vendosura nuk janë relevante dhe janë diskriminuese si dhe specifikacionet teknike nuk janë konform nenit 28 dhe hartimi i dosjes së tenderit nuk është konform nenit 27 të LPP, apo duhet të sqarohet ndonjë dëshmi rreth përgjegjshmërisë së tij, atëherë ka mundur të sqarohen paraprakisht, nëse edhe më tutje ka paqartësi dhe nuk merr përgjigje, mund të paraqes kërkesë për ri-shqyrtim në AK dhe pastaj ankesë në OSHP, ndërsa, në këtë rast ankesa është paraqitur në fazën e dhënies së kontratës, me ç'rast ankuesi i ka pranuar të gjitha kërkesa e Dosjes së Tenderit me rastin e ofertimit të tij në këtë aktivitet të prokurimit. Si rrjedhojë, paneli shqyrtues konstaton se edhe përmes platformës së e-prokurimit ankuesi para fazës së ofertimit nuk ka paraqitur asnjë ankesë në AK apo në OSHP, për këtë aktivitet të prokurimit, që do të thotë se i ka pranuar kërkesat dhe kushtet e ofertimit dhe për të njëjtat edhe ka ofruar çmime, Kjo konfirmohet edhe me Formularin e Dorëzimit të Ofertës, ku përmes këtij formulari ka deklaruar se i ka kontrolluar dhe pranon të gjitha kushtet e tenderit dhe dorëzon ofertën e tij financiar. E në fakte ky Formular sipas nenit 17.7 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimit Publik është pjesa kryesore e ofertës. Përveç kësaj dy ndryshime/plotësime janë bërë nga ana e AK dhe në asnjë rast nuk ka qenë diskutabile kjo pikë, përveç asaj Paneli Shqyrtues bëri një hulumtim edhe tek dy ofertat tjera pjesëmarrëse përveç të rekomanduara dhe që të dyja kanë ofruar specifikat e ushqimit.

Po ashtu edhe në nenin 20, pika 1 e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimit Publik, citon: “Në zbatim të Nenit 28 dhe 29 të LPP, AK do të parashtrij në dosjen e tenderit të gjitha specifikimet teknike të cilat çdo tender duhet ti përmbush.

Andaj, Mosplotësimi i kërkesave të DT nga OE sipas kërkesave të AK -se, përcillet me pasoja për OE te përgjegjshëm me eliminim nga gara. Përmes procesit, AK duhet të trajtojë procesin e vlerësimit në formën e tij barabarte për të gjithë OE në gare. Bazuar në këtë që u tha më lartë, dhe bazuar edhe në përgjigjen e AK dhe arsyet e eliminimit të ankuesit të cilën ky Panel Shqyrtues e mbështet, mund të konstatohet se OE nuk i ka paraqitur specifikimeve teknike me të

cilat do të ofertoj me qëllim që të dëshmoj përgjegjshmërinë e tij karshi kërkesave të Aneksit 1 të Dosjes së Tenderit dhe duke ju referuar edhe Udhëzuesi Nr.001_2023 për prokurimin publik, konkretisht nenit 10, PSH konsideron se AK ka vepruar drejtë.

Për të qenë konkurrues në një procedurë të prokurimit, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë të gjitha kushtet e kërkuara dhe të prezantojnë një ofertë të plotë dhe të rregullt në lidhje me autoritetin kontraktues. Ky proces duhet të konkurrojë transparencën e ndershme dhe të bëjë sigurimin e një zgjedhjeje sa më të mirë për autoritetin kontraktues. Në këtë kontekst edhe sipas gjykimit të pavarur të këtij paneli, AK por as OE, nuk duhet të thirren në dispozita nënligjore që të kërkojë sqarime shtesë për dokumentacionin e ofertuesve në çdo rast e aq më tepër kur këto dispozita nuk kanë karakter detyrues për AK (neni 72 i LPP), pasi siç u sqarua si më sipër të gjithë ofertuesit janë të vetëdijshëm për detyrimet dhe procedurat e aplikimit nëpër tenderë. Dhe nuk duhet të shihet si një arsye e vlefshme për të ndërhyrë në procesin e prokurimit në mënyrë të pamjaftueshme të arsyeshme. Kjo siguron që procedurat e prokurimit të mbeten efikase dhe të përmbushin qëllimin e tyre të sigurimit të kontratave publike në mënyrë të rregullt dhe të drejtë për të gjithë palët e interesuara.

E aq më tepër kur ankuesi ka sjellë dokument për dimensionet i cili është vështirë të përcaktohet se ka ekzistuar më herët në mënyrë objektive. Sipas nenit 38 "Sqarimi i Tenderëve", paragrafi 2 të Rregullat nr. 001/2022 për Prokurim Publik i cili citon: "Asnjë ndryshim në çmim ose kusht tjetër material ose aspekt të tenderit nuk mund të kërkohej, ofrohet ose lejohet."

Sipas nenit 40 "Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve", paragrafi 4 të Rregullat nr. 001/2022 për Prokurim Publik i cili citon: "Gjatë procedurës për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve asnjë komunikim dhe negociim nuk duhet të ndodhë në mes të autoritetit kontraktues dhe tenderuesve, përveç komunikimeve që janë autorizuar saktësisht nga nenet 34 dhe 35 të LPP. Megjithatë, vetëm sqarim i tenderëve mund të ndodhë pa ndonjë ndryshim të kushteve materiale ose aspekte të tenderit, përveç atyre të lejuara me nenin 59 dhe 72 të LPP-se"

Sipas nenit 40 "Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve", paragrafi 8 të Rregullat nr. 001/2022 për Prokurim Publik i cili citon: "Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga secili tenderues individualisht të sqaroj tenderin e tij /saj sipas nenit 38 të kësaj rregullore. Kërkesa për sqarim dhe përgjigjja duhet të bëhen me shkrim përmes platformës elektronike, por asnjë ndryshim në çmim ose në ndonjë kusht ose aspekt material të tenderit nuk mund të kërkohej, ofrohet ose lejohet."

Në nenin 45, paragrafi 20 të Rregullat nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sqarohen ndryshimet materiale, i cili citon: "Mundësia për pranimin e tenderëve, varet nga ajo se çfarë janë "aspektet materiale". Për sa i përket elementeve kontraktuale të dosjes së tenderit, çdo aspekt do të konsiderohet si material, nëse ka mundësi të ndryshojë kushtet e kontratës në lidhje me përshembull cilësinë ose kërkesat e performancës, çmimin ose mënyrën e pagesës, garancinë, sigurimin ose detyrimin dhe sidomos në rastet kur ndryshimi çon në një reduktim të drejtave kontraktuale të autoritetit kontraktues ose obligimeve të tenderuesit kontraktual.

Për sa i përket specifikimeve teknike, është e vështirë në përgjithësi për të dhënë shembullin se çfarë është "materiale". Në një fund të spektrit janë devijime që në realitet janë variante në rastet kur variante të tilla nuk janë të lejuara, shih nenin 29 të LPP-se, këto do të konsiderohen të jenë materiale. Megjithatë, edhe devijimet më të vogla në shumicën e rasteve do të konsiderohen materiale, kur ato ndikojnë për shembull në qëllimin bazë ose kapacitetet funksionale të asaj që

kërkohet në bazë të kontratës. Nëse një devijim është material apo edhe çdo devijim tjetër do të varet nga formulimi konkret i dosjes së tenderit. Në disa raste një zgjidhje e propozuar mund të devijojë nga ajo që autoriteti kontraktues e kishte imagjinuar dhe ende të përfshihen brenda kushteve të gjera apo të paqarta të dosjes së tenderit. Në këto raste është sigurisht formulimi i dosjes së tenderit dhe jo pritjet e autoritetit kontraktues që kanë rëndësi. Njësia matëse është nëse devijimi do ta bënte të pamundur për të krahasuar tenderët dhe për këtë arsye për të vlerësuar tenderët në mënyrë të barabartë. Siç është përmendur në 45.21 të kësaj rregullore dhe këtij autoriteti kontraktues do të jetë në gjendje të pranojë devijime të vogla në rastet kur devijimet të tilla mund të kuantifikohet.

Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga secili tenderues individualisht të sqaroj tenderin e tij/saj sipas nenit 38 të kësaj rregullore. Kërkesa për sqarim dhe përgjigjja duhet të bëhen me shkrim përmes platformës elektronike, por asnjë ndryshim në çmim ose në ndonjë kusht ose aspekt material të tenderit nuk mund të kërkojë, ofrohet ose lejohet" Sipas nenit 59, paragrafi 4 i LPP citon: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve."

Sipas nenit 72, paragrafi 3 i LPP citon: "Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive"

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "133 Pikat ushqyese për qentë endacak (furnizimi dhe shpërndarja e ushqimit) dhe QTE" me numër të prokurimit: 616-24-1368-1-1-1. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i kualifikon si pjesërisht të bazuara por jo bazë e mjaftueshme që aktiviteti i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim, ashtu siç është konstatuar më lartë

Andaj, Paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional dhe po ashtu përgjegjës sipas nenit 59.1 cituar "Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës". Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Pa nevojë për analiza tjera, OSHP niset gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitet buxhetore mirëpo AK duhet të kujdeset ex-officio edhe për parimet bazë të LPP-së dhe gjatë hartimit të kriterëve të dosjes së tenderit të mos hartojë specifikime teknike që bien ndesh me dispozitat e LPP-së.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - VIA EGNATIA SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: